



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	29.06.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtorca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTCK	3804/2022		115



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A/02/50/2017

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, bazuar në Aktgjykimin AA.nr.255/2021 të datës 23.05.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A/02/50/2017 të datës 10.02.2017 të parashtruar nga ankuesi me banim në fshatin

kundër Vendimit me numër protokolli 05 të datës 07.02.2017 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, në çështjen juridike "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datën 29.06.2022 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A/02/50/2017 të datës 10.02.2017 të parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 05 i datës 07.02.2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar sipas kontratës së punës me Nr. 19/2006 të datës 17.08.2006 në vendin e punës "Drejtore i Zyrës për buxhet dhe Financa" në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, më datë 17.01.2008 nga u.d. Sekretari Permanent i Ministrisë

për Komunitete dhe Kthim është bërë kërkesë për suspendim dhe Inicim të procedurës disiplinore në bazë të shkresës me numër 2382/2007 të datës 27.12.2007.

Udhëheqësi i Divizionit për Çështje Kadrovike, më datë 18.01.2008 ka nxjerr Aktvendimi me numër protokolli 82 me të cilin ankuesi është suspenduar nga puna deri në marrjen e vendimit nga Komisioni Disiplinor. Komisioni Disiplinor me datë 05.02.2008 nxjerr Vendim me Nr. 168 për shkëputjen e marrëdhënies së punës.

Ankuesi duke u bazuar në Aktvendimin me numër PKR.nr.328/13 i datës 26.11.2014 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, më datë 05.12.2016 ka parashtruar tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim kërkesë për kthim në punë, mirëpo nuk ka marr përgjigje.

Ankuesi më datë 25.01.2017 nëpërmjet postes ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, 07.02.2017 ka nxjerr Vendim me numër protokolli 81 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi, i pakënaqur me Vendimin me numër protokolli 81 të datës 07.02.2017 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, brenda afatit ligjor konform nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.02.2017 parashtron ankesën me numër protokolli 572/2017 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 13.02.2017 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria për Komunitete dhe Kthim. Më datë 23.02.2017 Ministria për Komunitete dhe Kthim ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura nga faqe 1-46.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 17.03.2017 ka nxjerr Vendim A/02/50/2017 me të cilin ka hedhë poshtë si të palejuar ankesën e ankuesit, ndërsa ankuesi kundër këtij vendimi ka hapur konflikt administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.880/2017 ka refuzuar kërkesëpadinë e ankuesit, ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykim AA.nr.33/2019 ka aprovuar ankesën e paditësit duke e kthyer lëndën në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.880/2017 ka refuzuar kërkesëpadinë e ankuesit kundër vendimit të Këshillit, mirëpo Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykim AA.nr.255/2021 ka aprovuar ankesën duke anuluar Aktgjykimin A.nr.880/2017 të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Vendimin A/02/50/2017 të Këshillit të Pavarur

Mbikëqyrë për Shërbimin Civil të Kosovës dhe duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje në Këshill.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 10.02.2017 e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 572/2017 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontrata e marrëdhënies së punës me numër 19/2006 e datës 17.08.2006; Njoftimin e datës 04.01.2008; Aktvendimin me numër protokolli 82 i datës 18.01.2008; Aktvendim me numër protokolli 137 i datës 29.01.2008; Vendimin me numër protokolli 144 i datës 31.01.2008; Aktvendimin me numër protokolli 168 i datës 05.02.2008; Aktvendimin me numër PKR.nr.328/13 të datës 26.11.2014 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda; Vërtetimin mbi pranimin e dërgesës nga Posta i datës 256.01.2017; Kërkesë për kthim në punës e datës 16.01.2017; Ankesën e datës 25.01.2017 e parashtruar nga ankuesi për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me numër protokolli 81 i datës 07.02.2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me numër protokolli 04/2 i datës 30.01.2017 për formimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin e Komisionit Disiplinor i datës 05.02.2008; Komunikatën me numër protokolli 170 e datës 05.02.2008; Shkresën elektronike (e-mailin) e datës 06.02.2008 nga _____ për ankuesin; Kërkesën e datës 17.01.2008 për suspendim dhe inicimin e procedurës disiplinore për shërbyesit civil të MKK-së në bazë të fletëparaqitjes nr. 2382/2017 të datës 27.12.2007; Njoftimin e shkëljes disiplinore me numër protokolli 109 i datës 24.01.2008; Shkresën për shkëljen disiplinore të supozuar e datës 29.01.2008; Kallëzim Penal i datës 28.12.2007; Procesverbal i seancës së Komisioni të Ankesave i datës 09.02.2017 dhe Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 778/2017 e datës 23.02.2017; Aktgjykimin AA.nr.255/2021 të datës 23.05.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimin AA.nr.33/2019 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimin A.nr.880/2017 të datës 04.02.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimin A.nr.880/2017 të datës 14.11.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Vendimin A/02/50/2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____ është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke marr parasysh vërejtjet e dhëna në Aktgjykimin AA.nr.255/2021 të datës 23.05.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar rastin e ankuesit dhe mbi bazë të të gjitha provave të lëndës, ka konstatuar që ankuesit mbi bazë të Vendimin me Nr. 168 të datës 05.02.2008 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim i është

ndërprerë marrëdhënia e punës, dhe në bazë të provave të lëndës të dërguar nga ankuesi dhe nga autoriteti punëdhënës nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi të ketë kontestuar këtë vendim përmes ndonjë veprimi administrativë.

Urdhëresa Administrative Nr.2003/2 për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës në nenin 1 tek përkufizimet konkretisht tek pika a ka përcaktuar se: *"Komision i ankesave do të thotë organi i emëruar nga organi i punësimit me qëllim të dëgjimit të ankesave kundër dënimeve disiplinore ose ankesave që dalin nga vendimet e drejtorëve"*, ndërsa neni 33 pika 33.1.a. i Urdhëresës Administrative Nr.2003/2 për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, ka përcaktuar se: *"Çdo organ punësimi duhet të themelohet një komision të ankesave për të dëgjuar ankesat e nëpunësve civil kundër ndonjë vendimit të komisionit disiplinor dhe ankesave ndaj drejtorisë siç janë: a. Vendimet disiplinor lidhur me nëpunësit civilë"*. Bazuar në këto dispozita ligjore të aplikueshëm në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, Kolegji, ka gjetur se ankuesi kundër Vendimit me Nr. 168 të datës 05.02.2008 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim nuk ka parashtruar ankesë në Komisionin e ankesave, sipas legjislacionit përkatës si më lartë si dhe dispozitave të nenit 7 paragrafit 7.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. MASHP/DASHC 2003/05 Procedurat e Ankesave i cili përcakton se: *"Ankesat duhet të paraqiten sa më shpejt pas ngjarjes me të cilën kanë lidhje. Në rastin e ankesës kundër selektimit, ngritjes në pozitë ose vendimeve të Komisionit diciplinor ankesat duhet të paraqiten brenda 30 ditëve"*.

Po ashtu në këtë periudhë kohore ka qenë i aplikueshëm Ligji Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, i cili në nenin 127 paragrafi 127.1 dhe 127.2 ka përcaktuar se: *"127.1. Ankimi administrativ mund të bëhet në formë të kërkesës për rishqyrtim ose të ankesës. 127.2. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet kundër një akti administrativ ose kundër refuzimit të paligjshëm për nxjerrjen e aktit administrativ"*, si rrjedhojë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqenëse ankuesi nuk ka parashtruar ankesë ndaj Vendimit me Nr. 168 të datës 05.02.2008 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, ka humbur çdo të drejtë nga marrëdhënia e punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Vendimi me numër protokolli 05 i datës 07.02.2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim është nxjerr në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe juridike.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda,02/50/2017,datë 29/06/2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe
- Arkivat të KPMSHCK-së.